



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4236 Prot.

Tiranë, më 04.07. 2023

URDHËR

Nr. 334, Datë 04.07.2023

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“INXHINIERI KIMIKE”, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Kimike” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Inxhinieri Kimike” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Kimike” në Universitetin Politeknik të Tiranës, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Universiteti Politeknik i Tiranës, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti Politeknik i Tiranës, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

